

L I G J
Nr.7884, datë 8.12.1994

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE TË ZHVILLIMIT (IDA) PËR
MBËSHTETJEN E PROGRAMIT EFSAC**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA) për mbështetjen e programit të rregullimit të sektorit financiar dhe ndërmarrjeve (EFSAC) për shumën 10.600.000 SDR.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.991, datë 22.12.199 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha